



Vazhdojnë trajnimet mbi sëmundjen e derrave dhe biosigurinë e fermave

Në katër trajnime në zona të ndryshme morën pjesë 47 pronarë të derrave dhe 12 veterinerë privatë



Foto: ©FAO

6 tetor 2021– FAO ka përfunduar një numër trajnimesh në pjesë të ndryshme në Kosovë për zbulimin dhe parandalimin e Mortajës afrikane të derrave (MAD) në fermat e derrave.

Sëmundja u zbulua për herë të parë në vitin 2019 në Serbi, pas shpërdarjes së saj në Ballkanin Perëndimor. Meqenëse sëmundja është ende e pranishme në vend, rreziku që ajo të hyjë në vendet dhe zonat fqinje, përfshirë Kosovën¹, mbetet një kërcënim i vazhdueshëm.

Në përgjithësi, u mbajtën katër trajnime në zona të ndryshme me pjesëmarrjen e 47 pronarëve të derrave dhe 12 veterinerëve privatë. Materialet e trajnimit janë zhvilluar nga ekspertë të FAO-s dhe janë përshtatur me rrethanat vendore dhe janë përcjellur tek pjesëmarrësit nga Jeton Muhaxhiri, ekspert lokal i FAO-s në këtë fushë.

Trajnimi një ditë përbëhej nga dy pjesë. Në mëngjes, u bënë prezantime mbi ndikimin e Mortajës afrikane të derrave, si përhapet sëmundja dhe mënyrat e zbulimit të saj. Pasditja iu kushtua biosigurisë në fermat e derrave dhe diskutimit të qasjeve specifike për parandalimin e Mortajës afrikane të derrave.

"Përfshirja e pronarëve të derrave dhe veterinerëve privatë është një aspekt i rëndësishëm i gatishmërisë ndaj Mortajës afrikane të derrave," tha Jeton Muhaxhiri. "Rritja e derrave kryhet vetëm në zona të caktuara dhe është jetike që t'i drejtohem këtyre komuniteteve për të rritur ndërgjegjësimin e tyre dhe për të dhënë këshilla se si mund t'a mbrojnë veten."

Në vitin 2019, FAO kreu një mision vlerësues për të përcaktuar kornizën e aktiviteteve të saj për sëmundjen e derrave në Kosovë. Në të njëjtin vit, për të rritur kapacitetin laboratorik, FAO organizoi një vizitë studimore të dy diagnostikuesve laboratorikë nga Laboratori i Referencës Kombëtare në Qendrën Burimore të FAO -s për ethet afrikane të derrave në Madrid, Spanjë, e vendosur në Qendrën për Kërkimin e Shëndetit të Kafshëve. Më vonë në vitin 2019, u mbajt një punëtori për gjuetarët për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sëmundjet tek derrat e egër. Vitin tjetër, një ushtrim simulimi u organizua në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Në vitin 2021, FAO mbështeti vlerësimin e kapaciteteve për zbulimin e Mortajës afrikane të derrave, përfshirë financimin e dërgesave të paneleve nga Qendra Burimore e FAO-s për Mortajën afrikane të derrave në Laboratorin Kombëtar të Referencës. Së fundi, gjatë verës së vitit 2021, në një aktivitet të mbështetur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural pas përhapjes së Mortajës afrikane në derrat e egër në Serbi, menaxherët e vendgjutive u trajnuan mbi këtë sëmundje dhe biosigurinë e gjuetisë.

"Në dy vitet e fundit ne u përqëndruam në të gjitha aspektet e gatishmërisë ndaj Mortajës afrikane të derrave dhe arritëm të përfshijmë të gjithë akterët kryesorë," tha Daniel Beltran-Alcrudo, këshilltar teknik për shëndetin e kafshëve. "Ne besojmë se kemi hedhur themelet për të luftuar Mortajën afrikane të derrave dhe shpresojmë që trajnimet dhe materialet për ngritjen e vetëdijes do të ndihmojnë Kosovën edhe pas mbylljes së projektit të FAO-s."

LIDHJET:

Mortaja afrikane e derrave: [Detection and diagnosis manual](#)

Publikimi: [African swine fever in wild boar](#)

[Kosovo prepares for diagnosis of African swine fever](#)

[Europe and Central Asia: Hundreds of veterinarians trained virtually in African swine fever preparedness](#)

[FAO and MammalNet joint app helps detect African swine fever in wild boar](#)

PËR MË SHUMË INFORMACION:

VIOLETA HYSENI KELMENDI

Specialiste për komunikim dhe informim publik

Violeta.Hysenikelmendi@fao.org

+383 45 727 777

Gazetarët & Redaktorët:

Për fotot, materialiet audio dhe video & b-roll, kontaktoni: (+39) 06 570 53625 ose FAO-newsroom@fao.org.

Mjetet online:

Fotot nëpërmjet [FAOnews Flickr account](#)

FAO [online newsroom](#)

[RSS feed](#) e njoftimeve për shtyp të FAO-s

[@FAOnews on Twitter](#)

Zyra rajonale e FAO-s për Europën dhe Azinë Qëndrore | 34 Benczur utca, Budapest, Hungary | [\(+36\) 1 461 2000](tel:+3614612000) | www.fao.org/europe